



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesë dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 362/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesë dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Muhamet Rexha dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosja (LVV) dega në Rahovec, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Rahovec, për shkak të vendosjes së banerit mbi rrugë publike, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 31.10.2013, mori këtë:

## VENDIM

**Miratohet** si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Rahovec, kështu që subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Rahovec, i shqiptohet dënimini me gjobë në vlerë prej 1400 (njëmijë e katerqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 28.10.2013, nga LVV, me të cilën pretendohet se me datën 26.10.2013, në fshatin Polluzhë në komunën Rahovec, anëtarë të subjektit politik AAK, kanë vendosur banerë të kandidatit për kryetar komune në këtë qytet Smajl Latifi mbi rrugë publike. Parashtresi i ankesës me këtë rast konsideron se është bëre shkelje e Nenit 33 pika b) e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), dhe neni 4.1 pika b) e Rregullës Zgjedhore Nr.11/2013.

PZAP-i, e informoi subjektin politik AAK, në kuptim të Nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 28.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 29.10.2013. Sipas afatit të caktuar, PZAP- i mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik AAK, në të cilën theksohet se vendosja e banerit të kandidatit të AAK-së, Smajl Latifi mbi rrugë publike në fshatin Polluzhë komuna e Rahovecit, nuk është bërë nga ana e strukturave të AAK-së, por pretendon se kjo mund të jetë bërë nga qytetarë apo individ të paidentifikuar me tendencën për të paraqitur shkelje të ligjit nga subjekti politik AAK. Poashtu AAK konfirmon se me të pranuar njoftimin për dukjen e banerit të kandidatit të AAK-së, mbi rrugë publike në Rahovec, ka udhëzuar strukturat menaxhuese të fushatës, konkretisht Shtabi Zgjedhor në Rahovec dhe ka bërë largimin e këtij baneri. Përgjigjes në ankesë subjekti politik AAK, i ka bashkangjitur provat siç janë: Udhëzimin e Kryetarit të AAK-së, drejtuar të gjitha strukturave të AAK-së, për respektimin e ligjit mbi zgjedhjet dhe Rregullave Zgjedhore, fotografë në të cilat dëshmohet veprimi i largimit të banerit të vendosur, kërkësën drejtuar shefave të shtabeve zgjedhore për respektim të Kodit Zgjedhor.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

**Ankesa është e bazuar**

Në bazë të fotografive në cilësinë e provës të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se baneri i kandidatit për kryetar të komunës së Rahovecit, Smajl Latifi i subjektit politik të AAK-së, është i vendosur mbi rrugë publike, gjë që është në kundërshtim me nenin 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, që ndalojnë vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugë publike.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rrethanat si rënduese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë rënduese mori se, subjekti politik AAK, ka marr pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se konsiderohet se është e njoftuar me procesin zgjedhor dhe faktin se baneri i kandidatit të AAK-së, për Kryetar të Komunës së Rahovecit, ka qenë i vendosur në vendin e palejuar për vendosjen e banerave. Ndërsa si rrethanë lehtësuese PZAP-i, mori se AAK, pas marrjes së kërkesës përgjigjes në ankesë nga PZAP-i, brenda afatit të caktuar, ka ndërmarr veprime të dukshme për evitim e shkeljes, duke i larguar menjëherë banerin nga vendi ku pretendohet se ka ndodhur shkelja e supozuar.

Prandaj PZAP-i duke marr parasysh të gjitha arsyet e lartësura se nga ana e AAK-së është shkelur nenin 4 paragrafi 1 pika "b" të Rregullës Zgjedhore 11/2013 të KQZ-së dhe nenin 33 pika b) të LZP-së, pasi që baneri i kandidatit për kryetar komune, të AAK-së, është i vendosur mbi rrugë publike, si dhe duke pasur parasysh veprimet e menjëherëshme të subjektit politik AAK-së, për evitim e shkeljes së supozuar si dhe përpjekjet për të parandaluar veprimet e ndaluara në bazë të provave të cilat i ka ofruar të bashkangjitura përgjigjes në ankesë të cilat veprime kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar, në kuptim të nenit 120 paragrafi 1 pika c), si dhe nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashresa në Prishtinë

Anr. 362/2013 më datën 31.10.2013.

Kryesuesi i Panelit  
Xhevdet Abazi



**Këshillë Juridike:** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.